

Lajmëtar, Njihe lajmin që po sjell!

J. L. May

Me një gjuhë piktoreske, Pali i shpjegoi Timoteut se ka rëndësi që predikuesi të jetë një rrugë e pastër e mesazhit të Perëndisë. Ai e krahasoi rolin e predikuesit me atë të një ene që përdoret për punë të mira. Në qoftë se predikuesi e ruan veten të pastër, ai mund të jetë një instrument i përdorur nga Perëndia, i dobishëm për çdo vepër të mirë (2 Timoteut 2:20–21). Asnjë njeri nuk mund të jetë lajmëtar i pastër i Lajmit të Mirë pa njohur burimin dhe zotëruesin e mesazhit. Pa burimin, mesazhi shtrembërohet. Kjo është e vërtetë sepse burimi është mesazhi. Keqkuptimi i mesazhit shpesh vjen nga mosnjohja e Perëndisë dhe e qëllimeve të Tij. Lajmëtari duhet të njohë Perëndinë në mënyrë që të njohë mesazhin e Tij.

Imagjinoni sikur hasni në një përrua me ujë të freskët. Habiteni se nga vjen ky ujë i freskët dhe i kulluar. Ecni përgjatë rrjedhës, deri lart në mal te burimi i saj, dhe shikoni një gurrë të madhe. Në grykën e burimit ka një formacion guri të pastër e të lëmuar, të larë nga uji që del prej burimit. Po të shikoni më tutje, ka vetëm shkëmbinj të cilët formojnë një rezervuar të pastër uji. Po të ktheheni mbrapsht, në drejtim të rrjedhës së ujit, do të vini re se uji bëhet gjithnjë e më pak i pastër, sa më shumë që largohet prej burimit. Vini re se ndërsa përroi rrjedh poshtë, larg nga burimi, ai mbledh baltë dhe lym nga toka. Në kohën kur arrin te një rrjedhë më e madhe në rrëzë të malit, uji i tij bëhet i turbullt. Në këtë pikë, shtrati i përroit, që shërben si rrugë për ujin, nuk krahasohet më me shtratin e përroit në grykën e burimit. Shtrati i përroit në afërsi të grykës së tij përbëhet prej të njëjtës material me vetë burimin. Larg burimit, shtrati i përroit nuk ka më të njëjtën përbërje.

Në të njëjtën mënyrë, sa më afër burimit

(d.m.th., vetë Perëndisë) të jetë lajmëtari i Fjalës së Perëndisë, aq më shumë do të bëhet si Perëndia dhe, kështu, ai do të jetë një rrugë më e pastër për bartjen e mesazhit. Predikuesi apo mësuesi i Fjalës së Perëndisë është vetëm një rrugë, një instrument i përdorur nga Perëndia për të bartur mesazhin e Tij. Rruga duhet të mbetet në hije, por mesazhi duhet të dëgjohet. Sa më shumë që t'i afrohem burimit të mesazhit, aq më shumë do të duam të lartësojmë mesazhin dhe aq më pak dëshirë do të kemi të lartësojmë veten tonë.

Si mund të shkojmë sa më afër burimit dhe si mund të qëndrojmë atje? Së pari, mund t'i afrohem burimit të mesazhit tonë me anë të studimit të Biblës. Në qoftë se duam të jemi të frytshëm në komunikimin e mesazhit biblik, duhet ta pranojmë Biblën si shfaqjen hyjnore të Perëndisë ndaj njeriut. Bibla, pra, është i vetmi lajm gojor apo i shkruar nga Perëndia. Perëndia mund ta shfaqë Vetën me anë të natyrës, me anë të një jete të mirë apo me anë të mënyrave të tjera të dukshme, por Bibla është dokument i shkruar që kemi nga Perëndia (1 Korintasve 2:9–10, 2 Timoteut 3:16–17, 2 Pjetër 1:20–21). Nuk ka asnjë rrugë të shkurtër për të marrë mesazhin e Perëndisë. Nuk mund të kërkojmë ta marrim atë me anë të një fjale të mrekullueshme apo me anë të një profecie. Mesazhi mund të vijë vetëm nëpërmjet orëve pambarim të leximit dhe të rileximit të Biblës.

Duhet ta lemë Biblën të na flasë. Jo vetëm që duhet ta lexojmë Biblën, por duhet ta lemë Biblën të na lexojë. Nuk mund t'ia themi Fjalën asnjëri tjetër në qoftë se nuk e lemë atë (Fjalën) të na flasë: “Besimi, pra, vjen nga dëgjimi, dhe dëgjimi vjen nga fjala e Perëndisë” (Romakëve 10:17). Mund të jetë shumë më e lehtë që të zgjedhësh një broshurë

apo një artikull në një revistë kristiane, ta lexosh atë dhe ta predikosh. Por, ai mesazh mund të jetë ose mund të mos jetë i vërtetë. Pavarësisht nga ai që e shkroi, në qoftë se nuk e shqyrtojmë broshurën apo artikullin nën dritën e Fjalës së Perëndisë, ajo që predikojmë mund të mos na çojë ne apo dëgjuesit tanë te burimi. Broshurat apo artikujt në revista janë të dobishme. Ato mund të na japin më shumë njohuri dhe mund të vënë në zbatim të vërteta që janë të dobishme për ne. Megjithatë, ato kurrë nuk duhet të zënë vendin e studimit të vetë Biblës. Mund të shpenzojmë kaq shumë kohë duke lexuar libra për Biblën sa që nuk kemi kohë të lexojmë Biblën vetë. Çfarë të drejte kemi të kërkojmë vëmendjen e njerëzve përderisa nuk e kemi fituar këtë të drejtë me anë të një përgatitjeje të duhur? Duhet të shikojmë dhe të sigurohemi se mësimi ynë është i vërtetë dhe sipas Fjalës së Perëndisë. Ne jemi përgjegjës për mësimet tona (Jakobi 3:1). Ka një ndryshim të madh midis atij që flet se ka diçka për të thënë dhe atij që flet sepse është i shtërnguar (nga dëshira apo detyra e tij) të thotë diçka.

Ne vetë duhet ta zbatojmë të parët mesazhin që predikojmë në jetën tonë, përpara se t'ua japim atë të tjerëve. Përndryshe, predikimi ynë do jetë vetëm fjalë të shumta të folura në ajër. Në qoftë se mesazhi ynë është për të inkurajuar dëgjuesit tanë, duhet më parë të na inkurajojë ne. Në qoftë se mesazhi ynë është për qortimin e një sjelljeje të caktuar, duhet më parë të shikojmë nëse ne vetë kemi nevojë për një qortim të tillë. Në qoftë se duam që dëgjuesit tanë ta dinë se kanë nevojë të lutem, duhet më parë të rikujtojmë se sa shumë nevojë kemi vetë për t'ua lutur më shumë. Mesazhi që kemi përgatitur duhet të prekë zemrat tona, përpara se të mund të prekë zemrat e dëgjuesve tanë. Mesazhin duhet t'ia drejtojmë vetes, përpara se t'ua drejtojmë të tjerëve.

Së dyti, mund t'i afrohem burimit të mesazhit tonë nëpërmjet lutjes. Perëndia na jep privilegjin e lutjes që të mbajmë të hapur rrugën e komunikimit me Të. Ndoshta e keni dëgjuar shprehjen: “Lutja i ndryshon gjërat”. Kjo është e vërtetë, por ka më shumë rëndësi që lutja të ndryshojë më shumë *njerëzit* se sa *gjërat*. Lutja ndryshon më shumë është atë që lutet.

Lutja është një bisedë me Perëndinë. Nëpërmjet lutjes, ia bëjmë të njohura Perëndisë kërkesat tona (Filipianëve 4:6). Lutja quhet edhe “lidhje e ngushtë me Perëndinë”. Nuk flasim me baballarët tanë vetëm kur kemi nevojë të urgjente për ndihmën e tyre. Në mënyrë të ngjashme, lutja është një takim me Atin qiellor, një bisedë me Të. Kur Jezusi u largua në mal për t'ua lutur, ishte si të vizitonte Atin e Tij. Sa mall që kishte për shtë-pinë!

Sigurisht, lutemi duke e ditur se Ati ynë qiellor ka dijen dhe fuqinë të na ndihmojë sa herë që kemi nevojë, ndërsa përgatitemi të predikojmë Fjalën e Tij. Përveç kërkesave që i bëjmë për të na bërë të mundur që të bëjmë vullnetin e Tij, kemi nevojë për fuqinë që vjen nga të qenit në prezencën e Tij. Lutja na çon në prezencën e Perëndisë.

KONKLUZION

Të njohim mesazhin që bartim do të thotë të njohim Atë prej të cilit vijnë të gjitha mesazhet me vlerë. Mesazhi pa atë që e jep do të tingëllojë bosh, pa shpirtin dhe autoritetin e duhur. Është e rëndësishme të mbajmë mend se autoriteti për të gjitha mesazhet biblike është Perëndia dhe jo ne. Mesazhet që përcjellim duhet të vijnë nga fjala e Perëndisë. Mesazhi është i Tiji. Ne jemi vetëm rrugët nëpër të cilat kalon mesazhi i Tij. Në qoftë se qëndrojmë pranë burimit, mesazhet tona do të jenë të sinqerta, të vërteta dhe me autoritetin e Perëndisë.

Marrë nga seria: “Efesianëve”
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara